



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.10.2022

MBLEDHJA Nr. 48,
Datë 27.10.2022, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 27.10.2022, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 48 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 14.10.2022 dhe datë 17.10.2022
2. Mbi kërkesën e deputetes znj. Jorida Tabaku për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.09.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh në muaj”
3. Mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për periudhën 01.01.2022-31.12.2022
4. Mbi miratimin e kontratës tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe furnizuesi i shërbimit universal (FSHU sh.a.), për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a., për periudhën kohore 01.01.2022 - 31.12.2022
5. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës të ALPEX sh.a. dhe të OST sh.a., për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e kërimit dhe shlyerjes), si dhe anulimin e rregullave të tregtimit, termat e përgjithshme, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 214, datë 28.12.2017
6. Mbi licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

8. Mbi kërkesën e shoqërisë “BIGWIND” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI